



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 406/4 prot.

Tiranë, më 27.04.2026

V E N D I M

Nr. 47, datë 27.04.2026

MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, TË VEPRIMEVE TË KRYERA NGA NJËSIA PËRGJEGJËSE, GJATË FAZËS SË VERIFIKIMIT PARAPRAK, NË PROCEDURËN E KONKURRIMIT TË ZHVILLUAR PËR PLOTËSIMIN E POZICIONIT “SPECIALIST NË SEKTORIN E DIASPORËS DHE MIGRACIONIT”, NË DREJTORINË E PROJEKTEVE TË HUAJA, INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS, NË INSTITUCIONIN E BASHKISË VLORË

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, në fazën e verifikimit paraprak, në procedurën e konkurrimit për plotësimin e pozicionit “Specialist në Sektorin e Diasporës dhe Migracionit, në Drejtorinë e Projekteve të Huaja, Integrimit European dhe Diasporës”, në këtë institucion,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është administruar informacioni i regjistruar me shkresën nr. 406 prot., datë 04.03.2026, nëpërmjet të cilit kandidati Orest Radhima, ngre pretendime për s’kualifikim të padrejtë dhe në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, nga njësia përgjegjëse, në fazën e verifikimit paraprak, në procedurën e konkurrimit të zhvilluar për plotësimin e pozicionit “Specialist në Sektorin e

Diasporës dhe Migracionit”, në Drejtorinë e Projekteve të Huaja, Integritet Europian dhe Diasporës, të shpallur nga Bashkia Vlorë.

Në këto kushte, nëpunësi ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike gjatë aplikimit të institutit të rekrutimit në shërbimin civil.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga konkurrenti Orest Radhima, ashtu si u evidentua më sipër, në mbështetje të kompetencave ligjore të sanksionuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar ka filluar procesin e verifikimit paraprak të informacionit, duke vënë në dijeni institucionin nëpërmjet shkresës nr. 406/1 prot., datë 27.03.2026, “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin paraprak të informacionit të administruar pranë Komisionerit, me shkresën nr. 406 prot., datë 04.03.2026, të dërguar nga kandidati Orest Radhima”, si dhe ka kërkuar të gjithë praktikën shkresore ku materializohen veprimet administrative të kryera në këtë rast.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, institucioni i Bashkisë Vlorë nëpërmjet shkresës nr. 3873/1 prot., datë 02.04.2026, “Mbi kërkesën për dokumentacion”, protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 406/2 prot., datë 08.04.2026, ka dërguar dokumentacionin e kërkuar, ku materializohen veprimet e kryera nga njësi përgjegjëse, gjatë procedurës së ndjekur për verifikimin paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pozicionin e publikuar.

Nga përmbajtja e dokumentacionit rezulton se, institucioni në respektim të legjislacionit të shërbimit civil, me shkresën nr. 1706 prot., datë 26.01.2026, “Kërkesë për shpallje”, dërguar në AKPA, ka publikuar procedurën e konkurrimit për grupin e pozicioneve “Lloji i diplomës “Arsim i Lartë”, niveli minimal i diplomës “Mastër Shkencor”, pozicioni “Specialist në Sektorin e Diasporës dhe Migracionit, në Drejtorinë e Projekteve të Huaja, Integritet Europian dhe Diasporës”, kategoria IV-2, në Bashkinë Vlorë.

Referuar përmbajtjes së shpalljes së publikuar për plotësimin e këtij pozicioni pune, konstatohet se, për të dy fazat, lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil, aplikohet në të njëjtën kohë, afati për dorëzimin e dokumentacionit për procedurën e lëvizjes paralele është përcaktuar në datën **05.02.2026** dhe për procedurën e pranimit në shërbimin civil, është caktuar data **10.02.2026**.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e konkurrimit për plotësimin e këtij pozicioni pune, rezulton se, kandidati Orest Radhima ka shprehur interesin për pozicionin e lirë, duke dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në shpallje pranë institucionit

të Bashkisë Vlorë, **në datën 25.02.2026**, protokolluar me nr. 3873 prot., datë 25.02.2026, në institucion, jashtë afatit të vendosur në aktin e publikimit, që ishte data 10.02.2026.

Në këto rrethana, me të drejtë, njësia përgjegjëse, në përfundim të procesit të verifikimit të kandidatëve, nëpërmjet postës elektronike (*e-mail i datës 27.02.2026*), ka njoftuar kandidatin O. Radhima, se nuk është kualifikuar për të marrë pjesë në fazën e dytë të konkurrimit, për arsye se, dokumentacioni është dorëzuar jashtë afateve të përcaktuara në shpalljen e publikuar.

Duke mos qenë dakord me përgjigjen, në respektim të afateve ligjore të përcaktuara, kandidati O. Radhima me e-mailin e datës 02.03.2026, ka depozituar ankim pranë njësisë përgjegjëse të Bashkisë Vlorë, e cila e ka marrë në shqyrtim ankesën dhe nëpërmjet e-mailit të datës 03.03.2026, i ka kthyer përgjigje kandidatit, duke argumentuar arsyet e s'kualifikimit të tij.

Sipas dokumentacionit të administruar për këtë procedurë konkurrimi konstatohet se, njësia përgjegjëse në institucionin e Bashkisë Vlorë, në zbatim të nenit 22, të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe pikës 2, të kreut IV, të Vendimit nr.243, datë 18.03.2015, "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*", të Këshillit të Ministrave, e ndryshuar, ku parashikohet se:

"Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim."

ka kryer verifikimin e kandidatëve pjesëmarrës nëse plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim dhe në përfundim të këtij procesi, në zbatim të pikës 5, të kreut IV, të aktit nënligjor të mësipërm, ka njoftuar individualisht kandidatin O. Radhima, për arsyet e s'kualifikimit, nëpërmjet e-mailit të datës 27.02.2026.

Në këto rrethana, lidhur me pretendimin për s'kualifikim të padrejtë, vërtetohet se, nga ana e njësisë përgjegjëse, si organ i ngarkuar nga ligji me detyra specifike në procesin e verifikimit të kandidatëve pjesëmarrës në këtë procedurë konkurrimi, janë kryer të gjitha veprimet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, për këtë fazë të konkurrimit.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; si dhe në mbështetje të nenit 16,

pika 6, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacionit nr. 406 prot., datë 04.03.2026, të dërguar nga kandidati Orest Radhima, duke qenë se, nuk konstatohen shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil gjatë realizimit të kësaj procedure konkurrimi, në kushtet kur, veprimet e njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Vlorë janë kryer në përputhje me ligjin.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Bashkisë Vlorë, si dhe kandidati Orest Radhima.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)